

# RELACION

## PËR

### AKTIN NORMATIV "PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA GJATË KOHËZGJATJES SË GJENDJES SË EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE"

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Në politikat kombëtare për përdorimin eficient të energjisë përcaktohen drejtimit për arritjen e objektivave kryesorë kombëtarë, mekanizmat, incentivat dhe financimet, për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në vend. Në këto politika një vend të rëndësishëm zë promovimi i efikasitetit të energjisë nëpërmjet zbatimit të mekanizmave të ndryshëm financiarë, përfshirë edhe incentivat përkatës, si dhe nxitja e investimeve në këtë fushë.

Vendi ynë merr një sasi të konsiderueshme energjie që vjen nëpërmjet rrezatimit diellor. Kjo sasi luhet nga 1200 kWh/m<sup>2</sup> në pjesën verilindore të vendit (zona që merr më pak energji të rrezatimit diellor) deri në mbi 1600 kWh/m<sup>2</sup> në zonën e Myzeqesë, e cila është zona më e pasur me këtë lloj energjie. Rrezatimi mesatar diellor mund të ndryshojë nga një minimum prej 3.2 kWh/m<sup>2</sup> në pjesën verilindore të Shqipërisë (ditë në Kukës) deri në një maksimum prej 4.6 kWh/m<sup>2</sup> në pjesën jugperëndimore (ditë në Fier). Kështu, Shqipëria ka një rrezatim mesatar diellor prej 4.1 kWh/m<sup>2</sup>.

Duhet theksuar fakti se pjesa më e madhe e territorit të Shqipërisë përfiton rrezatim diellor për më shumë se 2 200 orë në vit, ndërsa mesatarja e orëve me diell në të gjithë vendin është rreth 2 400 orë në vit. Po kështu, pjesa jugperëndimore e Shqipërisë përfiton rrezatim diellor për më shumë se 2 500 orë në vit dhe në Fier janë regjistruar shifra të një diellëzimi prej 2 850 orë në vit. Në Shqipëri numri i ditëve me diell luhet nga një mesatare 240 - 260 ditë në vit deri në një maksimum prej 280 - 300 ditësh në vit, për pjesën jugperëndimore.

Akti normativ "Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike" vjen në një moment mjaft kritik për sa i përket ndryshimeve që kanë ndodhur në tregun e energjisë. Energjia e shpenzuar për ngrohjen e ujit sanitar përbën në të shumtën e rasteve rreth 35 % të energjisë, që konsumohet nga abonentët familjarë dhe pjesa më e madhe e familjeve në vendin tonë garantojnë ujë të ngrohtë nëpërmjet përdorimit të energjisë elektrike. Nisur nga kushtet klimatike dhe pozita gjeografike që ndodhet vendi ynë, ekziston një potencial i jashtëzakonshëm që pjesën më të madhe ta

mbulojmë drejtpërdrejt nëpërmjet burimeve të rinovueshme. Në këtë mënyrë, ky projekt përveç se do të ndihmojë familjet shqiptare të reduktojnë shpenzimet e faturës së energjisë, por do të sjellë kursime prej rreth 3 milionë kWh/vit në rang vendi.

Qëllimi i këtij akti normativ është forcimi i zbatimit të masave dhe rregullave të detyrueshme për t'u zbatuar me qëllim uljen e konsumit të energjisë elektrike, për klientët jofamiljarë publikë, klientët privatë gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizim, si dhe masa financimi për klientët familjarë për kursimin e energjisë elektrike, duke financuar projekte për instalimin e impiantit të paneleve diellore për ngrohjen e ujit sanitar. Nëpërmjet mbështetjes financiare:

- do të nxitet rritja e prodhimit të energjisë prej burimeve të rinovueshme;
- do të rritet diversifikimi i përdorimit të burimeve të energjisë dhe sigurisë së furnizimit me energji në Republikën e Shqipërisë;
- do të reduktohet nevoja për energji elektrike me rreth 3 milionë kWh/vit;
- do të reduktohen emetimet me rreth 1 000 ton CO<sub>2</sub>;
- do të përmirësohet cilësia e furnizimit me ujë të ngrohtë sanitar.

Objektivi i këtij akti normativ konsiston në përcaktimin e masave detyruese, që do të merren gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, për klientët jofamiljarë publikë, për reduktimin e konsumit të energjisë elektrike të godinave të institucioneve të qeverisjes qendrore, institucionet e varësisë, institucioneve vendore, shoqërive dhe ndërmarrjeve publike, në masën 15 %, krahasuar me muajin respektiv të një viti më parë, masa të detyrueshme për reduktimin e konsumit të energjisë elektrike për klientët privatë, si dhe financimi për klientët familjarë në një shumë jo më të madhe se 70% të vlerës së impiantit të paneleve diellore për ngrohjen e ujit sanitar, me qëllim uljen e konsumit të energjisë elektrike.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Shfrytëzimi me efikasitet të lartë i burimeve energjetike, në funksion të zhvillimit të një sistemi elektro-energjetik të qëndrueshëm është një prej prioriteteve të programit të qeverisë, për të plotësuar kërkesën në rritje për energji elektrike brenda vendit, dhe, në këtë kuadër, dhe akti normativ i propozuar është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave.

Duke vlerësuar edhe situatën energjetike në vend dhe më gjerë marrja e masave për uljen e konsumit të energjisë elektrike do të ndikojë në qëndrueshmërinë e



furnizimit me energji elektrike përgjatë periudhës së dimrit, ku edhe konsumi energjetik është më i lartë.

Ky akt normativ është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë dhe Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, ku theksohet promovimi për përdorimin e energjive të rinovueshme në sektorin rezidencial, me qëllim uljen e konsumit final të energjisë elektrike në përputhje me objektivat e rekomanduar nga Komisioni Evropian dhe të miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

### **III. PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME TË KËTIJ PROJEKTAKTI**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë synon realizimin e objektivave kombëtarë në kuadër të zbatimit efektiv të Strategjisë Kombëtare të Energjisë dhe Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën. Për këtë arsye, zbaton programe me financime për të përmirësuar eficientësinë e energjisë në grupe konsumatorësh fundorë.

Përpara ndryshimeve të ligjit nr.124/2015, “Për eficientësinë e energjisë”, parashikohej krijimi i “Fondit për Eficientësinë e Energjisë”, si një mekanizëm financimi, që do të shtynte në përmbushjen e objektivave të Agjencisë për Eficientësinë e Energjisë. Me ndryshimet e reja në ligjin nr.28/2021, funksionet e “Fondit për Eficientësinë e Energjisë”, i kanë kaluar Agjencisë për Eficientësinë e Energjisë. Në këtë prizëm, financimi i këtij projekti mund të bëhet nëpërmjet Agjencisë për Eficientësinë e Energjisë.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Akti normativ i paraqitur është në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Duke marrë në konsideratë situatën e emergjencës në furnizim të shpallur me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është i nevojshëm miratimi i këtij akti normativ për të hyrë në fuqi në mënyrë të menjëhershme disa masa emergjente kursimi energjie.

### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE***

Ky akt normativ nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me ndonjë *acquis* të Bashkimit Evropian.

### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË AKTIT**

Ky akt normativ përfshin masat e nevojshme për uljen e konsumit nga klientët

jofamiljarë publikë, si dhe një sërë masash të veçanta që duhet të ndërmerren përgjatë periudhës së krizës energjetike, si për klientët jofamiljarë publikë dhe për klientët privatë.

Gjithashtu, ky akt normativ përfshin masat për financimin e klientëve familjarë për kursimin e energjisë nga panelet diellore, më konkretisht, një program subvencionimi për instalimin e paneleve diellore për ujin e ngrohtë në banesat familjare.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Institucioni kryesor që ngarkohet për zbatimin e këtij akti normativ është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E AKTIT**

Akti normativ është hartuar nga strukturat përkatëse teknike të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Akti normativ është propozuar nga ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Ky akt normativ nuk parashikohet të ketë efekt direkt në buxhetin e shtetit. Masat e financimit të paneleve diellore për ujin e ngrohtë do të financohen nga buxheti i Agjencisë për Eficiencën e Energjisë nga fondet që kjo agjenci përfiton nga shërbimi për të tretët. Këto fonde derdhen në buxhetin e shtetit në përfundim të vitit. Agjencia për Eficiencën e Energjisë ka përfituar rreth 1.1 milion euro nga shërbimet ndaj të tretëve. Parashikohet që kjo vlerë të jetë rreth 1.5 milionë euro deri në fund të vitit. I gjithë ky fond nuk do të derdhet në buxhetin e shtetit, por do të përdoret për financimin e këtij projekti.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**